

## STATUT

### I SHOQERISE TREGTARE "ELPLAST - AL" SH.P.K

Sot me date 05.09.2018 ne baze te ligjit nr.9901 date 14.04.2008"Per tregtaret dhe shoqerite tregtare " dhe Ligjit nr. 9723 date 03.05.2007" Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", dhe te ligjeve te tjera qe lidhen me veprimtarine tregtare ne Republiken e Shqiperise, me vullnetin e tij te lire , Edmond Luli , i biri i Pjetër Lulit, i datëlindjes 05.04.1984, lindur në Fushë -Arrës, Pukë dhe banues në Tiranë ,madhor dhe i afte per te kryer veprime juridike , i pajisur me Leternjoftimin me numer 024544370, numer personal I40415059W, leshuar me date 11.03.2009, ka vendosur krijimin e statutit te shoqerise "ELPLAST - AL" sh.p.k.

Ajo( shoqeria) eshte person juridik, e themeluar nga Ortaku themelues ne perputhje me legjislacionin per krijimin e funksionimin e shoqerive tregtare dhe do te zhvilloje aktivitetin e saj ne baze te ligjeve ne fuqi te siperpermendura.

Shoqeria tregtare "ELPLAST - AL" sh.p.k, rregullon poziten e saj juridike , marredheniet e themeluesve , te organeve te saj , llojin e shoqerise , kohezgjatjen e veprimtarise se saj , marredheniet me te punesuarit , etj, duke u bazuar ne ligjin nr.9901 date 14.04.2008"Per tregtaret dhe shoqerite tregtare " dhe Ligjit nr. 9723 date 03.05.2007" Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" dhe te dispozitave te tjera te legjislacionit shqiptar qe rregullojne marredheniet e shoqerise tregtare.

#### KREU I

#### EMERTIMI E REGJIMI JURIDIK , SELIA, KOHEZGJATJA , AKTIVITETI

##### Neni 1

#### EMERTIMI I SHOQERISE

ShoqeriaTregtare emertohet "ELPLAST - AL" sh.p.k, me themelues Z. Edmond Luli.

##### Neni 2

#### REGJIMI JURIDIK I SHOQERISE

Shoqeria udhëhiqet nga parimet e ekonomise se tregut dhe ka per qellim fitimin.

Shoqeria do te kete statusin e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar (sh.p.k) dhe do te perballoje humbje deri ne kufirin e kontributit te themeluesit te saj ne kapitalin e themeluar.

Veprimtaria e saj i nenshtrohet dispozitave te Statutit si dhe dispozitave te legjislacionit tregtar dhe atij civil ne fuqi.

Me vendimin e ortakut , shoqeria mund te ndryshoje regjimin juridik te saj ne perputhje me Statutin e saj , duke bere edhe pershtatjen e tyre sipas ndryshimeve perkatese.

Shoqeria gezon personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne Regjistrin Tregtar.

**Neni 3**  
**SELIA E SHOQERISE**

Shoqeria e ka seline e saj ne Tirane me adrese:  
Tiranë ,Yrshek, Zonën Kadastrale 3865 , numri i pasurisë 288/65,kati perdhe.  
Lloji i pasurisë Sipërfaqe ndërtimore prej 70 m 2 kati përdhe .  
Ajo mund te çele edhe seli te tjera te dyta , dege e filiale, perfaqesi dhe agjensi operative  
ne te gjithë teritorin e R,SH.dhe me miratimin e organeve kompetente edhe jashte vendit.

**Neni 4**  
**KOHEZGJATJA**

Shoqeria e formuar do te kete kohezgjatjen e veprimtarise se saj me nje afat te pacaktuar  
duke filluar nga dita e pershtatjeste statutit te saj.

**Neni 5**  
**OBJEKTI I VEPRIMTARISE**

Objekti i veprimtarise se saj do te jete :

**Prodhim, import, eksport të dyer, dritare, vetrata të prodhuara me materiale alumini, plastike dhe xhami.**

**Tregëti me pakicë të produkteve të profileve të aluminit dhe të plasztikave.**

Aktivitete ne fushen e tregtimit me shumice e pakice, import-eksport te artikujve te ndryshem industriale, ushqimore, prodhim e tregtim te materialeve te ndertimit , import-eksport te te gjitha produkteve te ndertimit.

Sherbime si specialist ne fushen e ndertimit si: Murator, suvatime, karpentier armaturash, shtrim pllakash, hekurkthyes, lysterje, riparime te ndryshme, instalime hidraulike, elektrike, montim e cmontim skelash etj.

Punime Gipsi, punime hidraulike, elektrike, punime karpenterie , punime druri ,punime metalike, punime plastike, punime xhami etj.

. Ndertime civile ,industriale, turistike, bujqesore mbi 5 kate. Rikonstruksione. Ndertim banese me skelet mbi 8 kate.

Punime bojatisje hidroizolime, termoizolime, akustike kundra zjarrit. Ndertim objektesh te permasave te ndryshme, shtepi, vila, ndertesa shumkateshe ose komplekse pallatesh, punime mirembajtje sherbime e fasada.

Ndertim ambiente dhe sistemim gjelberimi, parqe e Iulishte. Ndertim pika karburanti dhe tregtim me pakice te nenprodukteve te naftes. Tregtimin e karburanteve te ndryshme me pakice, si dhe vajra lubrifikante, te gazit te iengshem per ngrohje si dhe per makinat me impiant gazi, pajisje ngrohese gazi si dhe mbushjen e bomblave te gazit dhe tregtimin e tyre me pakice. Tregtim me shumice dhe pakice, import-eksport pajisjesh elektro-shtepiake, elektronike, elektrike, kompjuterike, higjeno-sanitare dhe hidraulike, prodhime qeramike, artizanati. pajisje zyrash etj. Tregtimin dhe prodhimin e materialeve te ndertimit e lendes se pare per ndertim, druri, mobilie, dyer, dritare, etj.



**Neni 6  
E DREJTA**

Shoqeria "ELPLAST - AL" sh.p.k është person juridik i së drejtës shqiptare e themeluar me vendim të ortakut themelues që ushtron veprimtarinë e saj tregtare në përputhje dhe në zbatim të legjislacionit shqiptar në fuqi, të ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe ligjit nr. 9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" e në përputhje dhe në zbatim të Aktit të Themelimit dhe Statutit të Shoqërisë.

**KREU II  
KUSHTET EKONOMIKE TË SHOQËRISË  
KAPITALI THEMELTAR . TRANSFERIMI I KUOTAVE TË KAPITALIT , E  
DREJTA E PRONËSISË SË SHOQËRISË**

**NENI 7  
FUNKSIONIMI**

Veprimtaria e funksionimit të shoqërisë bazohet në kërkesat e ekonomisë së tregut. Veprimtaria ekonomike ndërtohet mbi parimet e llogarisë dhe pasqyrohet në bilancet e saj.

**NENI 8  
PERBERJA E KAPITALIT**

Kapitali fillestar i investuar nga ortakët , përben bazën e krijimit të fondit themelor të mjeteve të xhiros.

Kapitali i shoqërisë do të përbehet nga kapitali themeltar, mjetet e xhiros dhe të tjera të nevojshme të luajtshme apo të pa luajtshme për ushtrimin e aktivitetit të shoqërisë.

Vlerësimi i kapitalit në natyrë është bërë nga ana e ortakut themelues në momentin e themelimit të shoqërisë

**NENI 9  
KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali themeltar i shoqërisë është 1.000 (njemijë) leke; i përbërë nga kontributi i ortakut themelues Edmond Luli nr personal I40415059W me 100% kontribut.

Vlera e kapitalit themeltar ndahet në 1 kuotë me vlerë nominale prej 1000 leke secila, kuota të cilat mund të tjetërsohen pjesërisht ose tërësisht.

Kapitali themelues mund të ndryshojë sipas vendimit që mund të marrë ky ortak, por asnjëherë nuk mund të pakesohet në nivelin e kapitalit themeltar fillestar të shoqërisë .

Kapitali është tërësisht i shlyeshëm e i nënshkrueshëm.

Çdo kuotë i takon e drejta e një vote.

**NENI 10**



## PRONESIA MBI KUOTAT

Kuotat e kapitalit dhe te drejtat qe rrjedhin prej tyre fitohen ose kalohen nepermjet:

-Kontributit ne kapitalin e shoqerise;

-shitblerjes;

-trashegimise;

-dhurimit;

-ne çdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

Transferim I kapitalit duhet te vertetohet sipas ligjit ,ndryshe jane te pavlefshme.

### NENI 11 MONITORIMI

Aktiviteti dhe rezultati i tij kokretizohen ne nxjerrejn e bilanceve periodike e vjetore.

### NENI 12 PERDORIMI I BURIMEVE

Shoqeria eshte pronare , perdorues, dhe disponuese e pasurise se saj.Ajo mund te bleje dhe mund te shfrytezoje te drejta materiale dhe jo materiale, duke perfshire edhe te drejten e shitjes se pasurise se vet tek te tretet, te jape ne perdorim , te ngarkoje me barre per detyrime ndaj te treteve ose per kredi bankare , etj. Ne Republikën e Shqiperise kjo shoqeri gezon te drejta si çdo person tjeter juridikshqiptar ose i huaj ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

### NENI 13 PERGJEGJESIA E SHOQERISE

Shoqeria vepron ne regjistrin e prones dhe mund te marre persipert e drejta dhe detyrime vetem brenda kapitalit te saj. Ortaku i vetem themelues mbart rrezikun e veprimtarise se shoqerise dhe vetem ne nivelin e investuar ne te.

## KREU III ORGANET DREJTUESE , ADMINISTRATIVE DHE VULA E SHOQERISE

### NENI 14 ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE

Organet drejtuese te shoqerise do te jene:

-Mbledhja e ortakeve-**Ortaku i vetem;**

-Bordi Drejtues i perbere nga **Administratori i saj ;**

Fusha e veprimit, perberja dhe menyra e funksionimit te organeve drejtuese rregullohet si me poshte ;

### NENI 15



## KOMPETENCAT E ORTAKEVE

Ortaku i vetem i shoqerise "ELPLAST - AL" sh.p.k. eshte shtetasi **Edmond Luli**.

Ai merr vendime per :

1. Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
2. Ndryshimet e statutit;
3. Emerimin e shkarkimin e administratoreve;
4. Emerimin e shkarkimin e likujduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
5. Percaktimin e shperblimeve per administratoret, likujduesit dhe ekspertet kontabel te autorizuar;
6. Mbikqyrjen e batimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire perгатitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
7. Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
8. Zmadhimin e zvogelimin e kapitalit;
9. Per shitjen e kuotave te kapitalit si dhe te transferimit te pjesshem apo te plote te tyre;
10. Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
11. Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
12. Miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asemablese;
13. Çeshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

### NENI 16 ADMINISTRATORI

Administratori i shoqerise "ELPLAST - AL" sh.p.k. eshte shtetasi **Edmond Luli**. Afati i qendrimit ne detyre e administratorit eshte 5(pese) vjet nga data e nenshkrimmit te ketij statuti dhe me te drejte rizgjedhje.

### NENI 17 KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

Administratori eshte i veshur me te gjitha fuqine per detyrimin e zakonshem e te jashtezakonshem te shoqerise pa asnje kufizim, duke perfaqesuar shoqerine ne kryerjen e çdo lloj veprimi te nevojshem gjate ushtrimit te veprimtarise se saj private.

Ai ka mundesi per te kryer te gjitha aktet qe konsiderojne te pershtatshem per arritjen e qellimeve te shoqerise.

Ai ka te drejte dhe detyra midis te tjerave ,qe :

1. Te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e pergjithshme ;
2. Te perfaqesoje shoqerine tregtare prane te gjitha institucioneve shteterore apo private.



3. Te bleje e te kembeje, dhuroje pasurite qe lidhen me shoqeri te tjera brenda dhe jashte vendit duke siguruar pjesmarrjen per qellimet e veprimtarise parashikuar nga neni 5 i ketij statuti;
  4. Te kryeje çdo lloj veprimi prane te gjitha institucioneve shtetore e private qe kane te bejne me garancite dhe veprime hipotekore , te kryeje prane te gjitha institucioneve bankare e financiare veprimi depozitimi, kreditimi, pagesa dhe arketime, lidhje kontratash dhe akt marreveshjesh te ndryshme si dhe veprime qe i sherbejne aktivitetit.
  5. Te kujdeset per mbajtjen sakte e te rregullt te dokumentave dhe te librave kontabel te shoqerise;
  6. Te pergatise dhe te nenshkruaje bilancin vjetor , bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise se bashku me propozimin per shperndarjen e fitimeve, ti paraqese keto dokumenta perpara asamblese se pergjithshme per miratim;
  7. Te krijojte nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;
  8. Te kryeje regjistrimet dhe te dergoje te dhena te detyrueshme te shoqerise sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit;
  9. Te kryeje detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut.
- Ne keto raste personi i ngarkuar nga administratori per perfaqesim eshte i detyruar te njoftoje e ti jape llogari atij.

#### **NENI 18 DREJTUESI TEKNIK**

Ne perputhje me ligjin per ushtrimin e ketij aktivitetit , shoqeria ka te drejten e emerimit apo te shkarkimit te Drejtuesit Teknik te saj.


Drejtuesi Teknik eshte drejtuesi me i larte teknik dhe pergjegjesi ligjor per drejtimin, bashkerendimin dhe kontrollin e ruajtjes dhe te sigurise fizike, pra te veprimtarise se shoqerise te percaktuar sipas nenit 5 te ketij statuti.

#### **NENI 19 PUNENSIMI**

Administratori , sipas nevojave qe paraqiten per zhvillimin e veprimtarise se shoqerise, puneson persona te cileve u cakton detyra dhe pagen. Shoqeria merr persiper te respektoje rregullat e punesimit ne R.SH dhe Sigurimeve Shoqerore.

#### **NENI 20 DREJTIMI TEKNIK I SHOQERISE**

Marredheniet e punes ne kete shoqeri rregullohen nepermjet kontrates se punes. Per ceshtjet qe nuk parashikohen ne to zbatohen dispozitat e Kodit te Punes ne R. SH. Mosmarreveshjet e punonjesve me shoqerine do te zgjidhen ne gjykatën shqiptare. Punonjesit e emeruar nuk marrin pjese ne ndarjen e fitimit te realizuar nga shoqeria gjate aktivitetit te saj , ne se ne kontrate nuk eshte parashikuar ndryshe. Per punen e kryer punonjesit marrin page sic eshte parashikuar ne kontrate.



#### **NENI 21**

Aktiviteti dhe rezultati i shoqerise konkretizohet me nxjerrjen e bilanceve periodike e vjetore.

Veprimet ekonomiko-financiare te shoqerise nisin ne vitin e pare ne momentin e regjistrimit ne organet tatimore , ndersa ne vitet e tjera ne 01 Janar dhe mbyllen me 31 Dhjetor te çdo viti.

Ne fund te çdo periudhe ushtrimore hartohet bilanci kontabel sipas ligjeve ne fuqi.

Bilanci vjetor paraqitet brenda dates 31 Mars te vitit pasardhes.

Bilancet periodike miratohen e nenshkruhen nga administratori , ndersa ai vjetor miratohet nga Mbledhje e Ortakeve –Ortaku i vetem i shoqerise. Me miratimin e tij,Ortaku i vetem vendos per krijimin e fondeve rezerve e te akumulimit. etj.

#### **NENI 22**

#### **PERDORIMI I TE ARDHURAVE**

Te ardhura neto pas veçimit te fondeve te siperpermendura dhe shlyerjes se detyrimit fiskal i mbesin Ortakut te Vetem te Shoqerise.Konvertimi i parase se realizuar do te behet sipas kushteve te bankes kombetare ose bankave te tjera te nivelit te dyte, ndersa transferimi i tyre do te behet sipas ligjeve shqiptare.

#### **NENI 23**

#### **VULA E SHOQERISE**

Shoqeria ka vulen e saj me permbajtje : “ELPLAST - AL” sh.p.k.

#### **NENI 24**

#### **KRIJIMI I SHOQERISE**

Shoqeria konsiderohet e krijuar ne perputhje me nenet e ketij statuti dhe aktit bashkelidhur dhe fiton personalitetin juridik me regjistrimin ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

#### **NENI 25**

#### **PRISHJAE SHOQERISE**

Shoqeria mund te priset ne çdo kohe per nje nga shkaqet:

-humbje kapitali;

-pamundesi veprimi;

Prishja e shoqerise regjistrohet ne regjistrin Tregtar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit . Prishja e shoqerise ka si pasoje hapjen e procedurave te likujdimit ne gjendjen e aftesise paguese , me perjshtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi.

Ne ket rast Ortaku i Vetem i shoqerise cakton nje ose me shume likujdatore.

Likujdoret dhe administratori jane pergjegjes per ruajtjen e pasurise per derisa t'ju dorezohen personave perkates duke likujduar ne radhe te pare detyrimet fiskale , taksat e tatimet, detyrimet e pagate punonjesve dhe detyrimet ndaj te treteve .

**DIPOZITA TE FUNDIT**  
**NENI 26**

Ky statut hyn ne fuqi pas miratimit dhe regjistrimit ne Regjistrin Tregtar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit.

**NENI 27**

Per sa nuk eshte shprehur ne kete statut i referohet plotesimeve qe do te beje Ortaku i Vetem si dhe ligjeve te veçanta ne te cilat eshte referuar hartimi i ketij statuti. Ndryshimet dhe plotesimet e ketij statuti behen ne te njeten menyre e procedure me te cilen nxirret vete Statuti.

**NENI 28**

Ky Statut perpilohet ne kater kopje me nga nente flete secila , per t'ju shperndare organeve kompetente dhe nje kopje mbetet ne dokumentacionin e shoqerise.

**ORTAKU I VETEM**  
**I SHOQERISE "ELPLAST - AL" SH.P.K**  
**EDMOND LULI**

